



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 234/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Nenad Lazić dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca për Ardhmërin e Kosovës (AAK) dega në Kamenicë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Kamenicë, për shkak të vendosjes së panove reklamuese në objekte publike të kandidatit të tyre për Kryetar të Komunës së Kamenicës, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 20.10.2017, mori këtë:

VENDIM

KONSTATOHET tërheqja e ankesës e subjektit politik Aleanca për Ardhmërin e Kosovës (AAK) dega në Kamenicë, ZL. A.nr. 234/2017 të datës 17.10.2017.

Arsyetim

Subjekti politik Aleanca për Ardhmërin e Kosovës (AAK) dega në Kamenicë ka paraqitur ankesë në PZAP kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Kamenicë, për shkak të vendosjes së panos në rrugë dhe në objekt publik të kandidatit për Kryetar të Komunës së Kamenicës nga radhët e LDK-së, për Zgjedhjet Lokale 2017.

Me datë 18.10.2017, ankuesi ka parashtruar kërkesë me nr. Protokolli 234/3 për tërheqjen e ankesë me numër: Anr.234/2017 të datës 17.10.2017.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës të ankuesit, në kuptim të nenit 115.1 të LZP -së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.234/2017 më datën 20.10.2017.

